



Pranuar / Dorezuar Punë/Produkt Received/Deliver	14.04	2023	3	viti Year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlopje Prilog Appendix	Sasia Kolicitet Quantity	
SIKOVSHICK	3564/2023		119	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.446/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.446/2022 të datës 02.03.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi:

_____ në çështjen juridike "*vlerësim i rezultateve në punë*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.446/2023 e datës 02.03.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 01.02.2023 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin për vitin 2022.

A r s y e t i m

Ankuesi, _____ sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Gjilanit, i pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë, me datë 02.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokolli:2242/2023 kundër Formularit për Vlerësimin e Punës për vitin 2022 të datës 01.02.2023 me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 08.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Komunën e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit me datë 23.03.2023 ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 02.03.2023 me Nr.Prot:2242/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 01.02.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 30.11.2021; Plani Vjetor i punës për vitin 2022; Raporti mujor për muajin Janar 2022 i datës 07.02.2022; Raport mujor-Shkurt 2022 i datës 08.03.2022; Raport për muajin Mars 2022 i datës 04.04.2022; Raport mujor -Prill 2022 i datës 05.05.2022; Raport mujor për muajin Maj 2022 i datës 07.06.2022; Raport mujor për muajin Qershor 2022 i datës 30.06.2022; Raport mujor -Korrik 2022 i datës 01.08.2022; Raport mujor-Gusht 2022 i datës 02.09.2022; Raport mujor-Shtator 2022 i datës 03.10.2022; Raport mujor-Tetor 2022 i datës 02.11.2022; Raport mujor- Nëntor 2022 i datës 02.12.2022; Raport vjetor -2022 i datës 10.01.2023; Raportet e rregullta javore për periudhën kohore për të cilën është vlerësuar; Pliko e bardhë R 2775911 i datës 28.02.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 08.03.2022; Përgjigja në ankesë e datës 23.03.2023; Akt emërim me numër 02-16-16460 i datës 14.02.2013; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 26.01.2022; Plani vjetor i punës për vitin 2022; E-mail i dërguar nga drejtuar i datës 20.03.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas aktit të emërimit me numër 02-16-16460 i datës 14.02.2013 mbanë pozitën "Shef i Sektorit për Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit" në Komunën e Gjilanit, ndërsa udhëheqësi i ti i drejtpërdrejtë përmes Formularit të Vlerësimit të Rezultateve në Punë i datës 01.02.2023 ankuesin e ka vlerësuar me notën e përgjithshme mesatare dy pikë nëntë (2.9) për vitin 2022, mirëpo i njëjti kishte shpreh kundërshtimin lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë përmes komentit në Formularin e Vlerësimit duke mos u pajtuar me vlerësim.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit sa i përket notës së përgjithshme të vlerësimit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik nën 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ku përcaktohet se: "Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.3. nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë" dhe ndërlidhur me paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 i të njëjtit nen dhe rregullore ku përcaktohet se: " Kuptimi i notave si në paragrafin

1 të këtij neni është si në vijim: "mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës", prandaj marrë për bazë Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për ankuesin i datës 01.02.2023 përmes të cilës ankuesi ishte vlerësuar me notë të përgjithshme mesatare dy pikë nëntë (2.9), Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se ankuesi është vlerësuar "mirë" në kuptim të dispozitave të lartcekura të rregullores, nga rrjedh si i njëjti ka realizuar të gjitha objektivat e punës dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit i paraqitur në ankesën e datës 02.03.2023 të parashtruar në Këshill është i pabazuar, ngase udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë nuk ia ka mohuar përkushtimin në punë sikurse as realizimin e të gjitha objektiveve.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit vlerëson se është për tu theksuar fakti se ankuesi formularin e datës 01.02.2023 përmes të cilit ishte vlerësuar me notë të përgjithshme dy pikë nëntë (2.9) nuk e ka nënshkruar me arsyetimin se është jo profesional dhe jo real pasi që të gjitha objektivat janë përmbushur plotësisht nga ana e ankuesit dhe se vlerësimet paraprake kanë qenë më të larta.

Prandaj, nga analizimi i shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit sikurse edhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e vlerësimit të ankuesit me notën e përgjithshme mesatare "dy pikë nëntë (2.9)- mirë" e që në kuptim të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik vlerësohet se i njëjti ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës, ndërsa ankuesi nuk ka mundur të mbështes pretendimet e tij ankimore se i njëjti është dashur të vlerësohet me notë më të lartë e që në kuptim rregullores së lartcekur pas notës së vlerësimit të ankuesit është nota "shumë mirë" me të cilën mund të vlerësohet nëpunësi civil i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektiveve dhe performancën e përgjithshme të institucionit, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit i paraqitur në ankesën e datës 02.03.2023 të parashtruar në Këshill është i pabazuar, ngase argumentet e tij nuk janë bindëse se i njëjti ka ndikuar në performancën e përgjithshme të institucionit, andaj mbi këtë bazë si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit është e pabazuar sikurse e njëjta është refuzuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa vlerësimi i rezultateve të punës së ankuesit për vitin 2022 të konkretizuara përmes formularit të datës 01.02.2023 është vlerësim i drejtë dhe i ligjshëm ngase udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 7 të së njëjtës rregullore, pasi që i njëjti është vlerësuar edhe për arritjen e objektivave sikurse edhe për sjelljet profesionale dhe kësisoj formulari i vlerësimit i datës 01.02.2023 ka mbetur në fuqi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.446/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.